

# Një histori e zakonshme???

Nga ENTELA BINJAKU

Sa më e varfër ekonomikisht, kulturalisht dhe në pikëpamje të impulseve pozitive shpirtërore, të optimizmit të jetë një shoqëri, aq më e pasur është ajo me aspekte të problematikës sociale dhe situatave për t'u trajtuar. Nëse shteti në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, fondacionet, shoqatat, organizatat apo grupimet qytetare, do të organizohet në përballimin e situatave të tilla, gjendja do të shkonte përherë drejt përmirësimit. Fatkeqësisht ne perjetojmë "një recension" të këtyre problematikave, në të cilat të zbulosh atë më të mprehtë, nuk është shumë e vështirë. Pikërisht, si drejtuese e Fondacionit "Harriet Martineau" dhe si sociologe, kam zgjedhur të bëj publike dhe të hedh thirrje për ndihmë të një prej historive më të dhimbshme, të trishta dhe më problematike që kam hasur në punën time, në këtë periudhë.

Në këtë larmi situatash në të cilën e gjëjmë veten, sot nuk është e vështirë të humbësh përqendrimin nga problemet që lidhen ngushtë me vetë ekzistencën dhe mbijetesën tonë.

Kjo që do të rrëfëj është historia e familjes Pitarka nga Grykë Nokë e Dibrës, një familje që jeton në mjerim të thellë. Asgjë e re deri këtu...një ndër të shumtat familje shqiptare..

Sot, në moshën 77-vjeçare Halil Pitarka dhe e shoqja, Nazife, jetojnë në mjerim të plotë, të sëmurë dhe pa ilaçe.. Edhe kjo asgjë e re...dhe duket krejt e zakonshme...megjithatë ata nuk dorëzohen para halleve që jeta ju ka vënë përballë.

E pazakontë është se para disa vitesh për të jetuar me ta erdhi dhe e bija, Pashe Pitarka. E ndarë nga 3 fëmijët dhe bashkëshorti, për arsye se ajo vuan nga depresioni, shkak i cili solli dhe ndarjen e saj. Sot ajo ka 8 vjet që nuk i ka parë fëmijët dhe gjithë ditën përmend vetëm emrat e tyre.

8 vjet janë vuajtje maksimale të kësaj krijese dhe po ashtu 8 vjet janë faje të rënda të gjithë strukturave shtetërore, shërbimit social dhe shëndetësor si dhe fyerje për gjithë shoqërinë tonë të civilizuar që kanë braktisur këtë njeri në fatkeqësinë dhe mjerimin e saj; ndërkohë që sëmundja është e shërueshme... Është vetëm një depresion. Pashe nuk ka mundësi të vijë në Tiranë dhe të kurohet rregullisht, ashtu si shteti nuk ka as mundësi ta marrë e ta shtrojë Pashe në spitalet e tij. Sigurisht Pashe nuk ka para të blejë kurën pasi të dalë nga spitali, dhe shteti nuk ka mundësi t'ja dhurojë këtë kurë. I vetmi njeri në rrethin e saj që po përpiqet ta ndihmojë deri më sot është një i afërm, i cili për këtë

i ka shkruar Kryeministrit aktual, por që tashmë nuk ka asgjë në dorë sepse i konsumoi "8 vitet e tij të lumtura". I ka shkruar ministrit të Shëndetësisë, i cili gjithashtu nuk ka asgjë në dorë, pasi me gjithë përpjekjet e tij nuk arriti të rregullojë këtë situatë alarmante të shëndetësisë sonë; i ka shkruar edhe kryetarit të ri të PD, ashtu si dhe kryetarit të PS, të cilët asnjëherë nuk gjetën kohë të mendonin për 8 vitet e shkuara të Pashes dhe për të gjithë jetën e saj në të ardhmen.

Ky njeri i afërt i shkroi edhe ish-Presidentit Topi, tashmë Kryetar i FRD-së, i vetmi që ju përgjigj kërkesës, duke vënë në lëvizje anëtarët e departamentit të çështjeve sociale të kësaj partie.

Në këtë tranzicion të stërzgatur kur çdo ditë në media dëgjojmë e përcjellim me dhjetëra raste vrasjesh e vetëvrasjesh, dhunimesh e grabitjesh, aksidentesh dhe fatkeqësish, askush nuk mendon seriozisht për arsyet e vërteta, për rrënjët e këtyre ngjarjeve dhe nuk bën asnjë analizë të hollësishme se nga një depresion i thjeshtë kanë ardhur shumë nga vrasjet që përmenden; Se nga mungesa e optimizmit dhe shpresës për të ardhmen vijnë shumë nga vetëvrasjet e mësipërme, vijnë konfliktet, dhunimet, ndarjet, e deri tek krimet. Ky është një rast tipik, i cili ka nevojë të ndihmohet nga shoqëria për pak fonde, sepse mund të marrë atë kënaqësi dhe dinjitet që i takon gjithësecilit prej nesh në shoqëri, por nëse lihet në gjendjen aktuale të saj, me siguri që ajo do të shkojë natyrshëm drejt degradimit të plotë. Si sociologe, dhe si drejtuese e fondacionit "Harriet Martineau" po hedh thirrjen për të gjithë ata që kanë mundësi ta ndihmojnë këtë grua, përmes së cilës kanë ndihmuar edhe familjen e saj, fëmijët që nuk i ka parë prej vitesh, bashkëshortin dhe prindërit e moshuar, motrat dhe vëllezërit e saj.



## Dilema e "fundit" e reformimit të sektorit energjetik shqiptarë

Nga Av. Dr. LORENC GORDANI

I avët e fundi opiniononi publik është njohur gjerësisht me rezultate e raportit të 6-mujorit të fundit të Bankës Botërore ku për sektorin energjetik vlerësohet se fokusi duhet të jetë ai i plotësisht të reformës së tregut energjetik. Njëkohësisht edhe duke ju referuar të njëjtit raport rikujtohet se të paktën vet procesi i ndarjes së kompanisë shtetërore u plotësua më 2008. Si rrjedhim shihet e nevojshme të kuptohet cili është thelbi i reformës që kërkohet të arrihet. Kuadër që në këtë shkrim do të mundohemi ta vëmë nën dritën e analizës ekonomiko-juridike - ndoshta disi shkurtazi për kompleksitetin që ajo mbartë - duke u mbështetur në profilet më kryesore dhe si rrjedhim mbi logjikën e përgjithshme që e përçon.

Reformimi i tregut energjetik në Shqipëri i ka fillimet e veta në kuadër të reformave - të njëkohshme me ato të vendeve të BE-së - të gjysmës së dytë të viteve '90. Targetet e së cilës në thelb synojmë rregullimin e çmimeve të energjisë sipas logjikave ekonomike ose e thënë më qartë rregullimi i tij t'i kthehet tregu (art. 3 i direktivës së elektriciteti dhe gazit). Për këtë së pari prodhuesi publik duhet të jetë i lirë të shesë në platforma telematike të tregut të brendshëm dhe atij rajonal në kohë reale (fillimisht për ditën e nesërme ose *Day-Ahead Market - DAM*). Objektiv që bëhet i mundur duke hequr kufizimet ligjore për furnizuesin publik për të blerë ekskluzivisht nga një gjenerator i përcaktuar dhe nga ana tjetër me kufizimin e rolit të tij me konsumatorët e vegjël. Targetet që duhet të përmbushen më transpozimin e plotë të Paketës së Tretë të Energjisë më afat të fundit 1 Janar 2015.

Profile këto, të cilat, siç kuptohet, do të kenë implikime jo pak të rëndësishme për të gjithë konsumatorët finalë. Në fakt për sa i përket konsumatorëve jo familjarë, që me reformën e dytë rregullatore të BE-së e më saktësisht më artikullin 21 të direktivës 2003/54/EC, është përcaktuar njohja e plotë e së drejtës për të

zgjedhur furnizuesin. Proces që mbetet të përmbillet tashmë me përfshirjen edhe të konsumatorëve familjarë brenda 1 Janarit 2015. Pra, nëse për kategorinë e parë tashmë afati ka kaluar, masa të shpjegta do duhet të ndërmerren për kategorinë e dytë nisur dhe nga vet gjerësia dhe kompleksiteti i përbërjes së saj.

Në lidhje me këtë aspekt më 22 qershor 2013 u plotësua me rregullat e funksionimit Komiteti Këshillues (Advisory Committee - AC) për Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve. Me këtë hap, Komiteti u bë plotësisht funksionalë dhe është i gatshëm për të nxjerrë një opinion ligjor për çdo rast mos përmbushje të *acquis communautaire* që do t'i referohet nga Këshilli i Ministror (MC). Konkretisht në Maj 2013, u regjistrua edhe rasti i parë (ECS-8/11) ku Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) paraqiti kërkesën e arsyetuar Këshillit Ministror në lidhje me legjislacionin e gazit të Bosnjë-Hercegovinës, i cili do të vendoset për t'ju kaluar apo jo AC-së nga Këshilli i Ministrave në mbledhjen e tij më 24 tetor të po këtij viti.

Në këtë perspektive, thelbësore bëhet të kuptuarit e motiveve që bëjnë që shtet pjesëmarrëse të kenë vështirësi për t'u raportuar me përmbushjen e objektivave nga ata vet të ndërrmarra. Shkaqet të cilat janë të shumta dhe jo pak objektive dhe mund të përmbledhen në aftësinë e kufizuar në *governance* politike dhe financiare, sidomos në vendet e EJT, për ndërrmarjen e reformave jo pak të vështira edhe për ato vende me më traditë në tregun e liberalizuar. Por nga sa është vërejtur deri më tani jo në pak raste edhe konsumatorët e mëdhenj kanë hasur vështirësi t'i përmbahen kësaj paradigme dhe ngulmojnë të mbeten në kategorinë e rregulluar/mbrojtur. Madje, për të evituar këtë rikthim, ECS kërkoi që brenda 31 Korrikut t'u dërgohet nga shtetet anëtare lista e plotë dhe e azhurnuar në vazhdimësi e kompanive të konsideruara si të "çliruar/emancipuar".

Njëkohësisht për sa i përket grupit të dytë të konsumatorëve

familjarë dhe atyre të vegjël çmimet e rregulluara të energjisë elektrike duhet t'i përmbahen kuadrit të përcaktuar për qëllime të sigurimit të shërbimit universal (art. 3 (3) i direktivës së energjisë elektrike) në përputhje me mbulimin e kostove. Aspekte që nënkupton mbulimin e të gjithë shpenzimeve reale të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë: kostot e prodhimit, koston për prokurimin nga prodhimi i brendshëm ose importi, investimet e nevojshme/një normë të përshtatshme fitimprurëse, kostot e shërbimeve të furnizimit dhe madje borxhet e qeqija.

Njëkohësisht, edhe në filozofinë e tyre, të gjitha çmimet e rregulluara duhet të jenë të kufizuar në kohëzgjatje për atë që është e domosdoshme për arrijtjen e objektivave të shërbimit publik të ndjekura duke ju përmbajtur dispozitave të nenit 3 (2) të Direktivës së Energjisë Elektrike (pra të definuar në mënyrë të qartë, transparente, jo-diskriminuese, të verifikueshme dhe garantuese të barazisë së aksesit). Njëkohësisht Autoriteti Kombëtar Rregullator (në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës) duhet të ngarkohet me kryerjen e raportimeve vjetore të metodologjive dhe nivelin e çmimeve të miratuar për klientët finalë.

Pra, në mbyllje, e gjitha e "shpëton sektorin" siç theksohet edhe në raportin e BB, pasi në tërësi synon kthimin e tij në dinamikat e efeciençës konkurruese të tregut. Logjikë që fillon nga mbrojtja e kategorive të cilësuar të dobëta (nëpërmjet përcaktimeve të qarta normative dhe adresimin reale të nevojave të tyre ekonomike) dhe vazhdon deri në forcimin - në përputhje me parashikimet e *acquis* - të qëndrueshmërisë së sistemit me parashikimet mbi "Furnizuesit e instancës së fundit". Pra, siç ka treguar dhe eksperiencia e deritanishme, përfaqja me logjikën e tregut të këtyre nevojave i plotëson ato më së miri, por cila do të jenë kostot me të cilën do të jemi në gjendje ta arrijmë këtë, ndoshta është dilema vërtet e fundit së cilës do të duhet t'i përgjigjemi tashmë edhe brenda kornizës së afateve të mirë përcaktuara të 31 dhjetorit 2014.